



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2163/11prot.

Datë 16.09.2025

V E N D I M
Nr.1261/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.09.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 1213/2025, datë 10.09.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoritetkontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “HTM” SHPK, me NIPT K97006004D dhe adresë: Shkoder, Lagja Perash, Rruga Rrojej, Nr 44.

Autoriteti Kontraktor:

SH.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë, me adresë Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 10.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1213/2025 ku vendosi:

- 1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “HTM” SHPK me numër ankimi elektronik A/2025/5659 dhe nr.2163/1/2025 prot, datë 11.08.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.*
- 2. Të pranojë pjesërisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2025/5658 dhe nr.2163/2025 prot, datë 11.08.2025 të operatorit ekonomik “HTM” SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
- 3. Autoriteti kontraktues të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues “HTM” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
- 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera*
- 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “HTM ” SHPK*
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 7. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 4126/3 prot., datë 15.09.2025 protokolluar me tonën nr. 2163/8 prot., datë 16.09.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1213/2025 datë 10.09.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 4126/3 prot., datë 15.09.2025 protokolluar me tonën nr. 2163/8 prot., datë 16.09.2025 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.1213/2025 datë 10.09.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.1213/2025 datë 10.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.1213/2025 datë 10.09.2025, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur,” me nr. REF-52473-06-26-2025, me objekt: “Rinovimi i impiantit shpërndarës 10kV në HEC Vau i Dejës që përfshin rikonfigurimin e skemës me dy seksione për të ruajtur redundancën, instalimi i 2(dy) TR 10/0.4kV dhe punime ndërtimore për krijimin e hapësirave”, me fond limit 150,000,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

